

## **Kënga Polifonike shqipëtare ,vlerë unikale botërore**

**Mr.Selami Kolonja**

### *Abstract:*

The Albanian polyphonic song was born with the first man on earth, then when he sang to life and death in an organized form with “the really crying”, with tears, a cry with pain and sob. Just like the Albanian language, that according to Konica, is among the oldest languages in Europe, so it is the polyphonic song which it is not influenced by Byzantine singing, because on the basis of musical and archaeological studies it had been sang 3-7 thousand years before Christ, it is more ancient than the Greek tragedy because even the drama of this mythology in this tragedy refers to this. Southern polyphony is the unique act of the manyvoices singing a-capela, the genius work of our talented people, manyvoices songs, models of ideas for the establishment of sophisticated choirs thousands of years later.

If this type of singing for secular people can be simply a kind of singing that serves to entertainment or life in general, for professional musicians these songs are artwork for their musical, melodic, harmonic, timbre and tonal construction, that is why and the interest in approaching and studying this kind of unique singing is large, both by foreign ethnomusicologists and by Albanian scholars. The polyphonic manyvoices singing is sung in the areas where the dialect of Tosk begins, so south of natural Albania, from Ladorishti to Cameri.

### *Abstrakt:*

Kënga polifonike shqipëtare lindi bashkë me njeriun e parë në tokë, atëher kur ai në formë të organizuar i këndoj jetës dhe vdekjes me të “ qarë prej vërteti “ , me lotë ,klithma me dhimbje e dënësë. Ashtu sikur se gjuha shqipe që sipas Konicës është ndër gjuhët më të vjetra në Europë , edhe kënga polifonike është po aq e vjetër dhe s’ka fare ndikim nga këndimi bizantin sepse në bazë të studimeve muzikore e arkeologjike ajo u këndua 3-7 mijë vjet para Krishtit , ajo është më e lashtë se vetë tragjedia Greke sepse edhe drama e kësaj mitologjie në këtë tragjedi i referohet kësaj .Polifonia e jugut është vepra unikale e këndimit shumëzërësh a-capela vepra gjeniale e

popullit tonë të talentuar ,këngë shumëzërëshe,modele idesh për themelimin e koreve të sofistikuara mijëra vjetë më pas .

Nëse ky lloj këndimi për njerëzit laikë mund të jetë thjeshtë një lloj këndimi që i shërben argëtimit ose jetës në përgjithësi ,për muzicentët profesionist këto këngë janë vepra arti për kah ndërtimi i tyre muzikor , melodik ,harmonik timbrik e tonal, pikërisht edhe interesi për tju qasur dhe studiuar këtë lloj këndimi unikal është i madh si nga etnomuzikologët e huaj por edhe nga studiuesit shqipëtarë . Këndimi shumëzërësh polifonik këndohet në zonat ku fillon të flitet dialekti Tosk ,pra në jug të Shqipërisë natyrale ,nga Ladorishti e deri në Çamëri.

**Fjalë kyçe : muzika , polifonia , shumëzërshmëria**

## **HYRJE**

Muzika popullore , apo folklori muzikor shqiptarë është mjaftë e pasur dhe e gjallë, veçanërisht muzika polifonike shqipëtare apo thënë më sakt këndimi shumëzërësh që në realitet është këndim i cili dëshmon origjinalitet , gjenetikë dhe lashtësi . Polifonia shqipëtare është mrekullia e traditës tonë kombëtare aq sa ka mrekulluar dhe frymëzuar jo vetëm shiet kulturore shqipëtare por i ka kaluar kufijtë gjeografik ,për këtë arsye ajo tani mbrohet edhe me Unesco si vlerë apo pasuri botërore . Ajo këndohet nga burrat, gratë, si dhe kombinimet e tyre nëntëvetësh ,prandaj në popull shprehimisht edhe sot e kësaj dite në viset ku ajo këndohet përdoret thënja ” *aj, tja marrim një me nëntë* ” ose merrja një Gjirokastrite ,një Myzeqare një Korçare ,pra në bazë të kësaj kërkese përcaktohet si të thuash mënyra e këndimit sips trevës. Këngëtarët janë autodidakt andaj pikërisht këtu dhe fillon enigma dhe kureshtja e studiuesve të folklorit sa që pas një koncerti polifonik një grup studiuesish gjerman pyetën se si këto këngëtarë kënduan pa partitura strukturat korale ,melodike , harmonike dhe korrespondencat polifonike . Kjo pyetje rrjedh natyrshëm për popujt e largët

sepse ata kur ndëgjojnë këngët polifonike ndëgjojnë shumzërshmëri apo zërash të mirë harmonizuara ,pra ndëgjojnë prijësin ( zërin e parë apo zërin që këndon temën melodike , pritësin (zërin e dytë që vazhdon melodinë marrë logjikshëm nga i pari ) zërin e tretë ( zërin mbajtës apo ison )si dhe zërat e tjerë që shpesh herë janë në rrolin e onomatopeimave apo imitimeve të ndryshme të fenomeneve që i rrethojnë këngëtarët , pra me të drejtë del pyetja se ku i kanë partiturat këngëtarët ,sepse në disa nga këngët polifonike çuditshëm këngëtarët nga strofa në strofë modulojnë disa herë për një sekondë të vogël te lart,siç kemi rast tek kënga e gurbetit ” Të përcollën nënë e nuse larg për në gurbet ” Kjo kërkesë harmonike e modulative është vështirë të kërkohet edhe tek ansamblet profesionale për vet delikatesën muzikore që ka .

### **Çështë këndimi polifonik shqipëtar ?**

Polifonia shqipëtare është dëshmia më e spikatur e talentit të popullit tonë ,dëshmi lashtësie e civilizimi ,demokratizimi , tolerance ,humanizmi e shpirtbardhësie ,apo më saktë kori parë në tokë .

Siç përmendëm më lartë solisti i parë quhej marrësi , i dyti pritësi ,prerësi ose këthyesi ,zëri i tretë hedhësi ose mbushësi , si dhe zëri i katërt iso . Iso për dallim nga tre zërat e tjerë është tingulli mbajtës , tingull i pandërprerë ,pra tingulli bazë i tonalitetit ku këndohet kënga .

Kënga polifonike shqipëtare lindi bashkë me njeriun e parë ,mijëra vjet para Krishtit ,për këtë flasin faktet arkeologjike e materiale , pra kënga polifonike lindi si dhimbje për të vdekurin dhe çlirim apo ngushëllim për të gjallët .

Sipas studiuesit dhe etnomuzikologut shqipëtar Vasil Tole polifonia shqipëtare është gjegjësisht kori i parë apo ansambli i parë artistik në botë , ky lloj këndimi lindi nga e ”qara me botë” me rrëke lotësh për njeriun si pjesë e botës , këngëtaët polifon qanin me dënësë kur

e përcillnin të vdekurin në varr nga zëra drithërues vajtimi dhe i këndonin me gëzim lindjes dhe natyrës së bukur .Ky pra është kori i parë në botë , i cili doli nga njerëzit e parë në këtë planet nga një grup njerëzish me intonacion të bashkuar , ndërsa Europës ju deshën pesë shekuj për ta formatuar polifoninë në kore të sofistikuara vokale .

### **Sa e lashtë është polifonia shqipëtare**

Studiuesit janë të mendimit se muzika polifonike është një kulturë teper e hershme bile më e lashtë se vetë tragjedia greke e cila i referohet asaj . Ajo është e lashtë 3-7 mijë vjetë para Krishtit dhe zanafilla e saj i takon kulturës së lashtë Pellazgo- Ilire fise të cilat sundonin tërë gadishullin por edhe më tej . Herë herë ka pas mendime se muzika polifonike ka ndikim nga muzika mesjetare bizantine por bazuar në të dhëna dhe fakte kjo fare nuk mban sepse lashtësia e polifonisë shqipëtare është shumë më e hershme se muzika bizantine , tezë e cila nuk pranohet nga masa e madhe e muzikologëve botërorë,bazuar në fakte teoriko muzikore. Ajo lindi në një tokë të caktuar dhe kultivohet vetëm në jug të Shqipërisë.

Është fakt se muzika Bizantine është e shkruar në tekst notal ndërsa muzika polifonike është egzistencë gojore dhe e pa shkruar e cila si ndërtim muzikor është e ndërtuar një sistem modal –tonal pentatonik ,mod i përbërë nga pesë tinguj të ndryshëm të vendosur në raport sekondash të mëdha dhe tercash të vogla , ndërsa muzika mesjetare bizantine është e ndërtuar nga një sistem modal –tonal diatonik ku përzihen tonet e plota gjysëmtonet dhe herë herë dhe sekondat e zmadhuara siç janë të njohura dhe meloditë Kukuzeliane .

Vetëm këto pak fakte të dokumentuara hedhin poshtë mendimin e mësipërm .

Për kah mënyrat e interpretimit mvarësisht nga vendi ,krahina polifonia shqipëtare interpretohet në disa mënyra linjash dhe atë veçojmë : Këndimin me dy linja melodike, këndimin me tre linja melodike ose tri zërësh ,melodi katërzërëshe këndime specifike të krahinave shqipëtare të Shqipërisë natyrale.

Këndimi polifonik sipas ndërtimit modal të lartëpërmendur fillon aty ku fillon dhe dialekti i të folmes toske, vendbanimin e ashtuquajtur Ladorisht i cili ndodhet në vend ku këndohet trezërëshi dhe më rrallë edhe katërzërëshi polifonik. Ky është dhe vendbanimi më i lashtë tosk i kësaj , vend me bazilikë e cila sipas ndërtimit supozohet të jetë ndërtuar në fund të shekullit V dhe fillim të shekullit të VI . Mandej këndimi polifonik me nuansa të njëjta këndimi gjendet dhe në Prespë, Pogradec, Kolonjë, Myzeqe Çamëri këndime të këngëve dhe valleve afërsisht të ngjajshme ,ndërsa në zonën e Labërisë këndimi polifonik kryesisht është katërzanor dhe nuansat e interpretimit dramatik ndyshojnë nga zonat e lartëpërmendura .

Studimi i parë mbi polifonin popullore shqiptare është shkruajtur nga studjuesi Ramadan Sokoli në vitin 1959 me titullin "Polifonia jonë popullore" dhe te libri "Folklori muzikor shqiptar "Tiranë i viti 1965.

Në këto dy libra jepet shtrirja gjeografike e të kënduarit polifonik jugorë i ndërtimit shumëzanore ,shkakallet pentatonike e polifonisë jugore ,pra në këto botime të cilët i përmendem më lartë jepen informacione mbi folklorin muzikorë shqiptar nga pikpamjet e klasifikimit polifonia .

Pra folklori muzikor shqiptar është shumë i pasur i cili i ka frymëzuar jo vetëm krijuesit tanë por i ka frymëzuar edhe autorë e kombeve të tjera për këtë arsye muzika popullore shqiptare e karakterizon numri i madhe të këngë lirike dhe epike qofshin të reja apo të vjetra, te këngët katundare dhe qytetare, vallet e lashta kreshnike veshjet popullore origjinale ,artitekturat ,skulpturat e pikturat dhe ato të kohës së sotshme, muzika instrumentale ku laramania e instrumenteve shqiptare është shumë ndryshe nga popujt tjerë, për këtë arsye folklori ynë është autokton dhe origjinal sa vetë njerëzimi të cilin i gjejmë në bazat tonale si dhe të shkallëve të vjetra, sidomos të asaj Jonike dhe të shkallët e Pentatonikës që është karakteristika apo veçantia e këngëve dhe valleve me këndim polifonik (tosk), prandaj në analizat e folklorit muzikor shqiptar do të vërejmë se ekzistojnë larmi këndimesh dhe atë : të kënduarit solo, në këndimet vokale shumë-zanore që sipas dialektit të të folmes tosk i quajmë këngë toske, vallet me këndim polifonik e vallëzim në masa të përziera , në veglat muzikore si dhe në koreografitë popullore,

pra këto janë vlera të cilët gjenden në hartat e etnomuzikologjisë shqiptare si vlerë unikal kombëtare ndërsa tash më edhe vlerë botërore .

Paraprakisht do të theksojmë se polifonia popullore nuk është vetëm një fazë e organizuar të aspektit harmonik horizontal të sekuencës melodike por është krejtësisht një dukuri e tërsishme e gjithë muzikës popullore shqiptare e viseve të jugut,pra siç do të themi më pas se polifonia popullore do të gjendet dhe do të konststohet jo vetëm atje ku ajo saktësisht edhe përcaktohet si e tillë psh: në këngët popullore polifonike dhe në polifonit me saze <sup>1</sup>

Edhe pse folklori ynë muzikor me gjithë ndarjen që ekziston përsëri është në gjendje të shpreh drejtpërdrejtë dhe me fakte se është origjinal dhe se ndryshon e nga folklori i popujve tjerë që na rrethojnë dhe si i tillë nuk krijon ndarje artificiale ndërmjet këngëve polifonike. Po ashtu krijimet nga folklori ynë, si epika dhe lirika popullore koreografike përmbajnë larmi këngësh shpesh herë këngë dhe valle bashk janë karaktere të ndryshme dhe larmi dhe forcë unikaliteti i madhështisë të krijuesit të talentuar popullor.

Në folklorin tonë muzikorë përdoren të dy dialekte gjuhësore, dialekti Gegë dhe Toskë, edhe kjo është një pasuri dhe vlerë e madhe kombëtare . Por me që objekt studimi i kësaj teme është polifonia e cila në ndërtim është ngushtë me shkallët pentatonike ne do të përqëndrojm fokusin tek e kënduara polifonike Jugore apo këngët që shtrihen tek e folmaja toskërishte .

Vlen të theksohet se polifonia vokale e këngëve shqipëtare herë herë shoqërohet dhe me instrumente popullore siç janë : fyelli,gajdja ,tamburaja etj ku këngët polifonike shoqërohen në ndodhi ngjarjesh si në ahengje festa e dasma .

### *a) Polifonia shqiptare dhe përhapja e saj*

Mund te themi se polifonia popullore nuk është vetëm fazë e një organizimi të formave melodike, por është një atribut i përgjithshëm i muzikës popullore të Shqipërisë së jugut. Pra, polifonia popullore gjendet edhe në këngët polifonike dhe në polifonitë instrumentale të sazeve, por ajo çka është më me rëndësi është vetë ” **iso-ja**<sup>2</sup>” që përbën mbetjen e një tingulli, për të cilin

<sup>1</sup> Vasil S.Tole Sazeet,muzika me saze e shqipërisë së jugut fq.20 Tiranë 1998

<sup>2</sup> Kultura popullore 1/1991”Burdoni isua në polifoninë shqiptare etnogjeneza fq. 58-59.

më e rëndësishme është që të theksohet se, vet tingulli është konsideruar si jo polifonik. Nga kjo duhet të hulumtohet mbetja<sup>3</sup>. Kjo do të na shërbejë si fillim për trajtimin e origjinës së polifonisë, duke iu qasur nga dy këndvështrime të ndryshme, ashtu që e para lidhet me ngjashmërinë e strukturës së shumëzërshe - polifonike, si dhe skemës së Isos, dhe e dyta përbënë një formë të re të shfaqjes së polifonisë, e njohur si polifonia e fshehur.

Polifonia jugore, apo polifonia me **iso** është një tingull i mbajtur gjatë që tregon se është një sinjalizim origjinal i muzikës popullore shqiptare. Pra kjo është një nga tezat më të rrahura e cila është e lidhur drejtpërdrejt me origjinën e polifonisë. Për vet faktin se zëri i njeriut gjithmonë ka qenë i klasifikuar si forma muzikore më e hershme, atëherë vetvetiu del se ai ka qenë instrumenti, apo, vegla e parë muzikore e tij.

Lidhur me veçorit e të bërit “iso” do të vërejmë se në polifoninë *toske* të burrave të zonave malore, burdoni (iso-ja), vendoset në lartësinë relative të toneve –lab-la-sib-si, kurse në zonat fushore do të vendoset me lartësinë relative të toneve të ulëta si psh: -do-do#-mi-fa-fa#-sol. Kurse për gratë në këngët e tyre për “iso”pëlqejnë lartësinë e tingujve -mib-mi-fa –fa#-sol.

Në polifoninë Labe të burrave, burdonin (iso-n) e gjejmë te lartësitë e toneve: la-sib-si-do1-do#1-re1, kurse te polifonia e grave *labe* burdoni e ndeshim në lartësinë e tingujve: la-sib--si-do1.<sup>4</sup>, mirëpo zanoret më të përdorura dhe më të preferuara janë zanoret- a,e,o-, po ashtu në disa këngë labe ndeshim edhe iso me gjashtë zanore si psh: a, e, o, i, u, ë.

Mirëpo iso-t polifonike i gjejmë edhe në hapësirën gjeografike ku përfshihen të gjitha pjesët jugore të Shqipërisë, ku nga pikëpamja e etnokulturës dallohen dy zonat të etnografisë: Toskëria<sup>5</sup> dhe Labëria<sup>6</sup> ku përfshihet Tepelena, Zagoria, Bregu i Detit dhe viset e “Labërisë muhamedanë”.

Siç përmendëm edhe më lartë, kënga polifonike këndohet edhe me tre zëra, apo vokale, dhe atë iso-polifonike e cila përdoret në disa vendet të Shqipërisë së jugut. Ndërkohë që këngët e iso-polifonike *toske* i këndohen në rrethin e lumenjve: Shkumbin, Vjosë, pastaj në krahinën e Korçës, Kolonjës, Leskovikut. Por ajo që duhet theksuar, se polifonia është kultivuar dhe kultivohet edhe në disa zona shqiptare në Maqedoni, dhe atë në Prespë<sup>7</sup> (fshatrat: Kranj, Gërçar, Bellocërkë të Poshtme dhe Bellocërkë të Sipërme, Nakolec, Asamat, etj. Por edhe në disa vendet

<sup>3</sup> Vasil S.Tole”Sazet e muzikës me saze te Shqiperëse së jugut fq.20,Tiranë 1998

<sup>4</sup> Kultura popullore 1/1991numri kengetareve të cilët mbajnë isp nga 7 deri 9 veta

<sup>5</sup> Rrok Zojzit “Etnografia shqiptare 1”fq.47

<sup>6</sup> Spiro Shituni “Polifonia labe”fq.15.Tiranë 1989

<sup>7</sup> Jane. C.Sugarman “Engendering Song”fq.620 Tiranë 1981

tjera në Maqedoni, sidomos nëpër fshatrat të Strugës,dhe atë në : Ladorisht, Fërngov, Zagraçan, Shum, Kalishtë dhe Fierishtë .

Duhet të theksojmë se këngët iso-polifonike trezërshe janë pjesë përbërëse dhe shumë të rëndësishme edhe të koreografisë folklorike. Ndërkohë që bashkekzistenca e këngës polifonike me folklorin e valleve koreografike krijon produktin origjinal të bashkëpunimit të muzikës popullore polifonike me koreografinë popullore. Me rëndësi të veçantë është edhe (për)mbajtja e valles që shprehet me anë të lëvizjeve, mimikës dhe shikimit të valltarit. Këtë e pasqyron shumë mirë edhe një thënie popullore në lidhje me strukturat e valles polifonike, kur thuhet: *”Valen nuk e loz mirë ay që e heq, po ay që ia mban<sup>8</sup>”*

Mirpo ekziston edhe dallimi ndërmjet isos polifonike labe edhe asaj ios toske dhe atë duke filluar me zërin isos ku nëpërgjithsi isoja polifonike tre zërsdhe toske nuk është silabike sikurse te isot e tre zërshit labe por është një **cluster pedal** pra kjo fjal don të thot se fillon edhe kënga në tre zërshin tosk është një fenomen e cila nuk spjegohet apo konsstatohet në rastet tjera pra me sa duket kjo bëhet për intonimin e nisjes të këngës nga pika më e ulët dhe për të vazhduar më tej,mbi këtë duhet të theksojmë se natyra e isos është dhënë me domethënjen e kuptimit të saj se në ç’bazë është ndërtuar zërat në shumzërshin polifonike cili në një anë është shumzërshi horizontal toskë dhe të asaj të shumzërshit vertikal labe,pra këto dy kuptime vërejmë këndimin horizontal tek tosket të cilët këndojnë si tek meshkujt ashtu edhe te femrat këndojnë këndimin polifonik horizontal melodik,kurse tek këndimet veritikal lab këndohet në mënyre vertikale harmonike akordike .

“Për polifoninë vokale kanë shprehur interes mjaft studiues-etnomuzikologë të huaj , por ajo që është interesant të theksohet se për vlerësimin e saj gjejmë të dhëna edhe në veprat letrare me karakter autobiografik .Xhorxh Gordan Bajron (1788-1824 ) në veprën e tij ” Çajld Haroldi ” , mes të tjerash jep këtë poezi mbresëlënëse të ndërtuar pas dëgjimit dhe efektit sugjestionues së valles të kënduar polifonike :

Në zall të shtruar ndritën zjarret natën  
 Darka mbaroi ,vjen rrotull verë e kuqe  
 Dhe kush u ndodh atje pa prituri gjë



Ju muar mentë fare nga ajo pamje  
Se sa pa shkuar orëz e mesnatës

Përcjellësit ia nisën këngës së tyre  
Çdo Palikar e flaku tutje shpatën  
Kërcyen dorë për dorë njëri pas tjetrit  
Me këngë apo vajtim u drodhën fustanellat <sup>9</sup>

<sup>8</sup> Marrë nga “Fjalë e urta të popullit shqiptar” fq.737Tiranë 1983

<sup>9</sup> Vasil S.Tole Polifonia & monodia Tiranë 2007 fq 18

#### LITERATURA E KONSULTUAR

- 1.Spiro .J Shetini ,Universiteti Winthrop - 1986
- 2.Ramadan Sokoli –Folklori muzikor sshqiptar Tiranë 1965
3. Ramadan Sokoli Gjurmimet folklorike Tiranë 1981
- 4.Vasil S.Tole-Folklori muzikor-Tiranë 2007
- 5.Rexhep Munishi –Probleme etnomuzikologjike-Prishtinë 1997
- 6.Kosta Loli- Kabaja me saze-dhe Kultura popullore 1984-Tiranë
- 7.Engjëll Berisha –Studime dhe vështrime për muzikën –Prishtinë 2004
8. Selami Kolonja – Universiteti i Prishtinës Punim diplome -1996



